

2021049741

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenit 25 paragrafi 1 dhe 3 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

**VENDIM PËR EMETIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 1000
DENARË ME KARAKTERISTIKA TË NDRYSHUARA**

1. Me këtë vendim emetohen kartëmonedhat me vlerë nominale 1000 denarë me karakteristika të ndryshuara.

2. Kartëmonedhat me vlerë nominale 1000 denarë janë me karakteristikat themelore të parapara në Vendimin për emetimin, vlerën nominale dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 45/96), Vendimin për emetimin dhe shtypjen e kartëmonedhave në vlerë prej 500 denarë dhe 1000 denarë me karakteristika të ndryshuara („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46/03) Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 500 denarë me karakteristika të ndryshuara („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 50/19), me këto ndryshime:

- Në Vendimin për emetimin, vlerën nominale dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 45/96) në pikën 2 д) në paragrafet 1 dhe 2, fjalët: „Народна банка на Република Македонија” (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë) zëvendësohen me fjalët: „Народна банка на Република Северна Македонија” (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Ven. nr. 02-15/III-4/2021
26.02.2021
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
D-r. Anita Angelovska-Bezhoska